



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1078/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha edhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën nga Adelina Krasniqi kandidate për anëtare të Asamble Komunale Aleanca për Lipjanin paraqitur kundër Qendrës së Numërimit të Rezultateve (QNR), për shkak të publikimit të rezultateve përfundimtare, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Adelina Krasniqit kandidate për anëtare të Asamble Komunale në Lipjan nga radhët e Iniciativës Aleanca për Lipjanin.

Arsyetim

PZAP-i, më datë 03.12.2013 ka pranuar një ankesë nga Adelina Krasniqi, e cila thekson se është kandidate për Asamble Komunale në zgjedhjet lokale në Komunën e Lipjanit e cila thotë se QV- 1322E/01R dhe në QV-1322E/02R më janë barturë votat e mia në emër të kandidatit tjetër po të njëjtit subjekt.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP-i konstatoi nga shkresat e lëndës se kandidatja në fjalë nuk i ka argumentuar me prova pretendimet për të cilat potencon se janë bërë parregullsi, andaj për shkakun se nuk janë ofruar dëshmi bindëse për të vërtetuar shkeljet që janë cekur në ankesë, PZAP-i në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 1078/2013 më datën 06.12.2013



Këshillë Juridik:

Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës Brenda njetzetkater (24) oreve nga moment i marrjes së vendimit nga PZAP-i.